
STATUTI
I
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT“ SHPK

Kreu 1
DEPOZITA TË PËRGJITHSHME

FORMIMI I SHOQËRISË

NENI 1

a.Sot në Tiranë në datën 03/09/2021 themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT“ sh.p.k,me vullnetin e lirë të ortakëve, në bazë të ligjit 9901 datë 14.04.2008 ”Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“, formohet shoqëria me përgjigjësi të kufizuar “GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT“ sh.p.k,nga ortakët themelues:


Z. YASIR ABAKER ABDULMULA AHMED shtetas Sudanez I datëlindjes 03-08-1969 lindur në Marshang,Sudan. madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore,me nr Pasaporte **P07235201**.

Z. GAMAL ABDELNASSER AHMED ABDELGALIL shtetas Egjiptian I datëlindjes 01-06-1962 lindur në .BANI SOUWAIF Egypt. madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore,me nr Pasaporte **A23120283**.

Z. MOHAMED MOHAMED HASSAN ELSHARKAWY shtetas Egjiptian I datëlindjes 18-03-1960 lindur në KALYOBIYA,Egypt. madhor e me zotësi të plotë për të vepruar pa pengesa ligjore,me nr Pasaporte **A04207940**.

Neni 2

1. Shoqëria tregtare është e organizuar si shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe mban emërtimin : “GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT“ SHPK.
2. Ortakët e kësaj shoqërie marrin përsipër të paguajnë pjesën që u takon nga humbjet e aktivitetit tregtar në këtë shoqëri sipas pjesës së tyre takuese.
3. Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare mund të ruhet i njëjti emërtim me kusht që personi juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.



Neni 3

1. Shoqëria tregtare "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" SHPK do të përmbushë objektin veprimtarisë së vet me një afat të pacaktuar kohe. Ky afat


mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas rregullave të parashikuara në këtë statut dhe legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 4

1. Shoqëria tregtare "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" SHPK ka selinë qendrore në territorin e Republikës së Shqipërisë në qytetin e Tiranës Rruga "Njazi Meka", **perballe pallatit nr 1 Allias**. Tirane
2. Shoqëria tregtare "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" SHPK me regjistrimin e këtij statuti pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, mund të marrë masa për të patur një adresë interneti si dhe një postë elektronike për komunikim. Këto adresa do të jenë të vlefshme për të tretët vetëm pasi t'i jenë njoftuar Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me pikën 2 të nenit 69 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
3. Shoqëria mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjenci në qytete të tjerë të Shqipërisë ose jashtë vendit.
4. Ajo mund të jetë pjesëmarrëse në një shoqëri tregtare apo mund të kontrollojë shoqëri të tjera tregtare si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
5. Njësitë strukturore të shoqërisë në format e mësipërme do të krijohen në përputhje me legjislacionin shqiptar kur ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin e vendit ku personi juridik ka qendrën e vet.
6. Shoqëria do të ketë vulën e saj dhe logon e saj. Forma dhe përmbajtja e vulës përcaktohen me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme, vula e shoqërisë dhe logoja mund t'i raportohen Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 5

1. Shoqëria tregtare "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" SHPK ka fituar personalitet juridik që nga dita e regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" (i ndryshuar).
2. Ndryshimet e shoqërisë duke përfshirë edhe përcaktime të mëvonshme në lidhje me kohëzgjatjen e aktivitetit të saj nuk sjellin si pasojë krijimin e një personaliteti juridik të ri.



Neni 6

Shoqëria tregtare "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" SHPK ka si objekt te veprimtarisë se saj:

- Kontraktimi i përgjithshëm- Bar - Kafe, restorant, piceri, makina me qera, transport udhëtaresh, transport mallrash, shërbime katering, trajnime, konsulentë për kurse kuzhine etj.
- Aktivitet në fushën e Real Estate: shit-blerje, dhënie dhe marrje me qira të pasurive të paluajtshme, troje, tokë bujqësore, apartamente, njësi tregtare. import- eksport me shumicë e pakicë, Kryerja e ransporteve kombetare dhe ndrekombetare te mallrave te veta dhe per llogari te treteve.Te gjitha veprimtarite e tjera ne fushen e transportit,tregtare,financiare ,ekonomike dhe te ndryshme te
- cilat nuk bien ne kundertshti me kushtetuten dhe ligjet e Republikes se Shqiperise.

Neni 7

1. Shoqëria tregtare "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" SHPK nuk përgjigjet për detyrimet që rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale që ortakët zhvillojnë në mënyrë të pavarur prej saj.

Kapitali

NENI 8

Kapitali themeltar I shoqerise përbëhet nga 100.000 leke (nje qind mije leke), I cili eshte tërësisht kapital financiar.

Kapitali themeltar është i ndare ne 3 (tre) koute, ku njera kuote ka vlere norminale 20.000 leke,(Njzet mije leke) kuote e dyte ka vlere norminale 40.000 leke, (Dyzet mije leke) dhe kuote e trete me vlere norminale 40.000 leke, (Dyzet mije leke)

.Kapitali themeltar zoterohet nga :

1. **YASIR ABAKER ABDULMULA AHMED**,zoterues I 1 (nje) kuote apo 20% te kapitalit te shoqerise.

Ortaku kanë të dretjtë të tjetërsojne, të zmadhojne apo te pakësojne kuotat e kapitalit deri në kufinjte e përcaktuara nga ligji.

2. **GAMAL ABDELNASSER AHMED ABDELGALIL**, zoterues I 1 (nje) kuote apo 40% te kapitalit te shoqerise.

Ortaku kanë të dretjtë të tjetërsojne, të zmadhojne apo te pakësojne kuotat e kapitalit deri në kufinjte e përcaktuara nga ligji

3. **MOHAMED MOHAMED HASSAN ELSHARKAWY**, zoterues I 1 (nje) kuote apo 40% te kapitalit te shoqerise.

Ortaku kanë të dretjtë të tjetërsojne, të zmadhojne apo te pakësojne kuotat e kapitalit deri në kufinjte e përcaktuara nga ligji

Neni 9


1. Në bazë të pjesëmarrjes së kapitali themeltar në shoqëri, fitimi shpërndahet ortakëve në raport me kuotën e zotëruar. Ky fitim i shpërndahet ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit :
 - a) Aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - b) Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve.
1. Në rast të plotësimit të kushteve të sipërpërmendura në këtë nen, nga ana e administratorit të shoqërisë lëshohet një çertifikatë që tregon aftësinë paguese të
2. shoqërisë. Në të kundërt një çertifikatë e tillë nuk mund të lëshohet. Lëshimi i një certifikate të tillë në kundërshtim me këtë nen, ngarkon administratorin me përgjegjësi.
3. Të ardhurat neto që do të rezultojnë nga bilanci i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme do të shpërndahen si vijon :
 - a) 5 % për fondin rezervë, deri sa ky fond të arrijë 1/5 e kapitalit themeltar;
 - b) pjesa tjetër i shpërndahet ortakëve në raport me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin themeltar.

Neni 10

1. Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera të veçanta të financimit për zhvillimin ekonomik e tregtar. Krijimi i një fondi të tillë, bëhet gjithmonë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 11

1. Përbërja e kapitalit të shoqërisë, fondet e krijimit të saj si dhe përdorimi e rregullimi i çdo fondi të veçantë përcaktohen nga organi përkatës sipas të drejtave dhe detyrave të përcaktuara në statut.
2. Të ardhurat e përgjithshme të shoqërisë dhe në përgjithësi çdo operacion financiar i saj do të pasqyrohen në kontabilitetin e shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe në mbështetje të akteve përkatëse të rrjedhura prej tij.



Neni 12

1. Shoqëria tregtare "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" SHPK është pronare e pasurisë së saj të cilën e përdor dhe e disponon atë në emër të saj në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë.
2. Shoqëria është e lirë të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar.
3. Të gjitha shpenzimet për ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistencë teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqërisë.

Neni 13

1. Pasuritë e shoqërisë vlerësohen në monedhë shqiptare.
2. Aktiviteti financiar i shoqërisë do të mbyllet me 31 Dhjetor të çdo viti dhe bilanci do të miratohet brenda tre muajve të vitit në vazhdim.
3. Llogaritë vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta të hartuara nga administratori që merret me kontabilitetin dhe/ose transaksionet financiare dhe eventualisht nga audituesi ligjor miratohen me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 14

1. Kuotat kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarje pasurore midis bashkëshortëve si dhe ndërmjet pasardhësve dhe paraardhësve.
2. Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes/humbjes së personalitetit juridik (nëse është person juridik) së ortakut gëzon të drejtat e titullarit të cilat do ti kishte ai. Por ama me përjashtim të faktit që përpara se të realizohet ky regjistrim i kuotës duhet patjetër të bëhet dorëzimi përkatës.

Neni 15

1. Transferimi i kuotave të kapitalit themeltar me trashëgimi ose brenda familjes personave përfitues do të bëhet pasi ata të pranojnë përmbajtjen e statutit të kësaj shoqërie tregtare me gjithë ndryshimet që ai mund të ketë pësuar deri në momentin që këto pjesë të kapitalit themeltar bëhen të transferueshme.



Neni 16

1. Kuotat e kapitalit mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri. Miratimi i transferimit të kuotave nga Asambleja e Përgjithshme është i nevojshëm.
2. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata.
3. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshirë këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit të pronësisë.
4. Kuotat e kapitalit themeltar fitohen apo kalohen sipas përcaktimeve të nenit 73 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar).
5. Pjesëtimi i kuotës së ortakut është i lejueshëm sipas nenit 75 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar).

Neni 17

1. Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributeve në natyrë apo zvogëlimi i tij behet me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme mbi bazën e një projekti të paraqitur nga audituesi ligjor/eksperti kontabël i autorizuar (regjistruar) dhe me kërkesën qoftë edhe të ndonjërit prej administratorëve apo ortakut.
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Përgjithshme e cila merr vendime në të njëjtat kushte sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 18

1. Asambleja e Përgjithshme, mund të vendosë që rritja e kapitalit të bëhet dhe me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të cilat figurojnë deri në datën 31 dhjetor të vitit/viteve financiar/financiare paraardhës/paraardhëse. Kjo gjë bëhet vetëm pasi Asambleja e Përgjithshme, me vendim të ketë miratuar llogaritë vjetore të shoqërisë për vitin/vitet e mbyllur/mbyllura financiar/financiare paraardhës /paraardhëse.



2. Pas marrjes së një vendimi të tillë, Asambleja e Përgjithshme cakton një auditues ligjor për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashpërndara të shoqërisë, gjendje të datës 31 dhjetor të vitit paraardhës.
3. Pas prezantimit të aktit të vlerësimit nga audituesi ligjor, Asambleja e Përgjithshme i/e shoqërisë, me një vendim tjetër, përcakton mënyrën e rritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë.
4. Pas marrjes së vendimit të dytë nga Asambleja e Përgjithshme, e gjithë procedura e ndjekur në zbatim të këtij neni do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Regjistrimin e Biznesit".

KREU I DYTE **Ortakëria**

Neni 19

1. Ortakëria për shoqërinë tregtare "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" SHPK. është krijuar dhe mbështetet në këtë Statut, Akt Themelimi dhe në ligj.

Neni 20


1. Shoqëria Tregtare "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" SHPK, ka vetëm 3 (tre) ortakë, të drejtat dhe detyrimet e të cilëve përcaktohen në këtë statut dhe në Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar).

Neni 21

1. Ortakët e shoqërisë tregtare "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" SHPK. gëzojnë të gjitha të drejtat dhe merr përsipër detyrimet që pasqyrohen në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe në Statutin e shoqërisë.

Neni 22

1. Të drejtat dhe detyrat e ortakut:
 - Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme;
 - Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë;
 - Të informohet mbi përmbajtjen e raportit të administrimit, inventarët e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, e raportin e audituesit ligjor;
 - Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
 - Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;
 - Të ushtrojë të drejtat e tjera të parashikuara në legjislacionin shqiptar.



KREU I TRETË
Organizimi i shoqërisë

Neni 23


1. Shoqëria tregtare "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" SHPK ka si struktura drejtuese :
 - Asamblenë e Përgjithshme si organi vendimmarrës për shoqërinë;
 - Administratori

Neni 24

1. Asambleja e Përgjithshme, si organ vendimmarrës për shoqërinë, është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorit/administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të audituesve ligjorë;

 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;

 - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, nga një person i tretë në bazë të një autorizimi ose prokure të noterizuar.
3. Autorizimi ose prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
4. Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Forma e regjistrit dhe mbajtja e vendimeve përcaktohen me vendim të Asamblesë së




5. Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme, me vendim, mund të ngarkojë dhe një person fizik për mirëmbajtjen e regjistrit të mbledhjeve.
6. Nga ana e Asamblesë së Përgjithëshme dhe/ose Administratorit, merren të gjitha masat përkatëse për regjistrimin e vendimeve të saj pranë organeve përkatëse shtetërore dhe sidomos në veçanti, vendimet për:
 - a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - d) vendimet e marra në zbatim të nenit 18 të këtij statuti.
7. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.
8. Asambleja e Përgjithshme, me vendim, mund të autorizojë dhe persona të tjerë përveç administratorit për regjistrimin dhe depozitimin e vendimeve të tija pranë organeve përkatëse shtetërore.
9. Vendimet e Asamblesë së Përgjithëshme merren duke respektuar kuorumet përkatëse të përcaktuara në ligjin Nr. 9901 datë 14.07.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar).

Neni 25

Thirrja e Asamblesë

1. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohet në rastet e përcaktuara nga Ligji Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, thirret dhe zhvillohet të paktën një herë në vit.
2. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga kryesisht nga vetë ortaku i vetëm apo njëri nga ortakët, ose administratori/administratorët sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të thirret edhe nga
3. Audituesi Ligjor dhe/ose Administratori i shoqërisë kur ka nevojë për diskutime për çështje ekonomike që lidhen me shoqërinë.
4. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.
5. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga personat e tjerë të parashikuar nga pika 2 e këtij neni jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.



Neni 26
Administrimi i Shoqërisë

1. Sipas nevojave që paraqiten për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë, asambleja e ortakëve emëron dhe punëson administrator dhe drejtues teknik, të cilët qëndrojnë në detyrë deri sa revokohen nga shoqëria ose largohen me dëshirën e tyre. Administrator I emëruar I ka të gjitha kompetencat për të vepruar në emër të shoqërisë me përgjashtim të rasteve të vecanta që ligji I jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

2. Administratorë të Shoqërise do jenë:

Z. YASIR ABAKER ABDULMULA AHMED.

Z. . GAMAL ABDELNASSER AHMED ABDELGALIL.

Z. MOHAMED MOHAMED HASSAN ELSHARKAWY.

të cilët përfaqësojnë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët për një periudhë 5 (pesë) vjecare dhe me të drejtë rizgjedhen.

3. Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij me shkrim në formën e autorizimit ose me prokurë.
4. Shoqëria në të ardhmen mund të administrohet dhe nga një administrator tjetër, I cili emërohet me vendim të Ortakëve.


Neni 27

1. Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje te ligjeve, për shkelje te Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Neni 28

Administratori ka këto të drejta:

1. Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet e saj me të tretët, e në administratën publike;
2. Të emërojë pranë shoqërisë personelin e domosdoshëm që I nevojitet asaj në përmbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik;
3. Të paraqesë për miratim në Asamblenë e Ortakëve strukturën e brendshme organizative të shoqërisë me emra përkatës dhe të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni I punës Republikës së Shqipërisë;
4. Të administrojë pasurinë dhe mjetet financiare të shoqërisë Brenda kufinjve të caktuara nga Asambleja e Ortakëve;
5. Të testojë aftësitë e punojësve në administratë;
6. Të thërrasë Asamblenë e ortakëve dhe të propozojë çështjet që duhen analizuar;
7. Të hartojë objektivat e shoqërisë për cdo vit pasuesdhe të vendosë e të ndjekë realizimin e detyrave të lëna nga Vendimet e marra nga Ortakët;
8. Të hartojë planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqesë ato për miratim nga Asambleja e Ortakëve.



Neni 29

1. Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në përputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.

KREU I KATËRT Bashkimi dhe ndarja e shoqërisë


Neni 30

1. Shoqëria tregtare "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" SHPK me anë të bashkimit mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ato themelojnë që ushtron te njëjtin aktivitet.
2. Gjithashtu shoqëria "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" SHPK me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.
3. Në rast se operacioni përfshin krijimin e shoqërive të reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave që i përkasin shoqërisë që do të krijohet.
4. Transferimi i plotë i aktivitet të shoqërisë apo kontributi në aktiv të një shoqërie tjetër, veçanërisht me anë të procesit të bashkimit duhet të autorizohet nga Asambleja e Përgjithshme.
5. Bashkimi, ndarja apo shndërrimi i shoqërisë, realizohet në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar).

KREU I PESTË Prishja dhe likuidimi i shoqërisë

Neni 31 PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

1. Shoqëria mund të priset në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjerë që nuk varen nga ortaku/ortakët.
2. Shkaqet e prishjes së shoqërisë, por pa u kufizuar në to, mund të jenë:
 - a) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - b) në rast se objekti bëhet i perealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;



-
- c) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar);
 - d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - e) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - f) për çdo shkak tjetër të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme
3. Shoqëria hyn në fazën e likuidimit qysh në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Asambleja e Përgjithshme, me vendim, emëron një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre.

Neni 32

1. Likuidimi i shoqërisë tregtare "GOLDEN TRIANGLE TRADING & INVESTMENT" SHPK. vendoset nga Asambleja e Përgjithshme kur priset shoqëria.
2. Likuidimi i shoqërisë do të bëhet duke zgjedhur procedurën e zakonshme të parashikuar në nenet 192 -203 të Ligjit Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 33

1. Në qoftë se Asambleja e Përgjithshme, për mbylljen e parashikuar, nuk mund të marrë vendim ose ai nuk pranon të miratojë llogaritë e likuiduesit vendimi merret nga Gjykata me kërkesën e likuiduesit ose çdo personi të interesuar.
2. Nëse nuk është proceduar si më sipër Gjykata me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme zbaton dispozitat ligjore dhe në se miratimi nuk është dhënë deri në seancën e parë gjyqësore ky miratim prezumohet i mirëqenë.

Neni 34

1. Në fund të procesit të likuidimit thirret Asambleja e Përgjithshme për të vendosur në lidhje me bilancin financiar përfundimtar.


DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 35

E gjithë veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në ligjin 9901 datë 14.04.2008" Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare" si dhe në legjislacionin në përgjithësi të Republikës së Shqipërisë .

Neni 36

1. Ky Statut përpilohet në 5 (pesë) kopje origjinalë secili me të njëjtën vlerë ligjore.
2. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë;
3. Ky statut hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.




ORTAKËT E SHOQËRISË

Z. YASIR ABAKER ABDULMULA AHMED



Z. GAMAL ABDELNASSER AHMED ABDELGALIL



Z. MOHAMED MOHAMED HASSAN ELSHARKAWY

